

**RAPORTI I EKSPERTIT TE MJEDISIT MBI SECILIN PREJ RASTEVE TE PROPOZUARA PER RISHIKIM, KU DETAJOHET:**

- 1. NESE SECILI PREJ RASTEVE CENON OSE JO VLERAT NATYRORE, MJEDISORE DHE ZONAT E MBROJTURA,**
- 2. NESE SECILI PREJ RASTEVE DUHET T'I NENSHTROHET OSE JO HARTIMIT TE VSM-SE**

Bashkia Kavajë ka përgatitur kërkesat e saj për rishikimin e Planit të Përgjithshëm Vendor me procedurë të thjeshtuar si më poshtë. Kërkesat ndahen në dy grupe:

- 1. kërkesa për ndryshim vetëm të treguesve zhvillimor.**
- 2. kërkesa për ndryshim të kufijve të njësive strukturore dhe të treguesve zhvillimor.**

Kërkesat janë mbështetur në:

- a) Ligjin Nr. 139, datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar,*
- b) Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar,*
- c) VKM Nr. 686, datë 22.11.2017, "Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit", e ndryshuar,*
- d) konsultimet me AKPT dhe me qytetarë të Bashkisë Kavajë, investitorë potencial të vegjël dhe të mëdhenj, në fushën e turizmit, industrisë ushqimore, ndërtimit apo agroturizmit, të cilët kanë ndikuar ndjeshëm për zhvillimin e zonës,*
- e) karakteristikat që vet territori i bashkisë Kavajë ka, një ndërthurje e jashtëzakonshme e kodrave të buta me bregdetin.*


Kërkesat për ndryshime janë në përputhje me kërkesat e ligjit Nr.107/2014 dhe VKM Nr. 686/2019, pasi ndryshimet nuk sjellin ndryshime të strategjisë kërkohet vetëm ndryshime të treguesve zhvillimor ose ndryshime të treguesve zhvillimor dhe ndryshime të kufirit të njësive brenda zonave urbane.

Kërkesat për ndryshime nuk çenojnë zonat e mbrojtura mjedisore dhe natyrore, as zonat e trashëgimisë historike e kulturore.

Vlerësojmë se ndryshimet e kërkuara perfshihen ne ndryshimet qe trajtohen me procedure të thjeshtuar, sipas percaktimeve te pikave 3 dhe 4 te Nenit 11, te VKM 686/2017, e ndryshuar), duke u bazuar pikërisht tek pikat 3 dhe 4 te Nenit 11.

Më poshtë paraqitet vlerësimi i ekspertit mjedisor mbi:

- 1. Ndikimin e ndryshimeve në vlerat natyrore dhe mjedisor**



## 2. Nevojën ose jo që rastet për ndryshim ti nënshtrohen procesit të Vlerësimit Strategjik Mjedisor.

Përsa i përket çështjes a çënohet mjedisi, në gjykimin tonë, mjedisi dhe ambjenti në njësitë strukturore që preken nga ndryshimi i PPV do të jetë njësoj i çënuar, pra nuk do ketë cënim shtesë në rastet e kërkesave për ndryshim që kërkojnë vetëm ndryshim të treguesve zhvillimor. Ndikimi do të jetë i papërfillshëm, pasi ndryshimet janë ndryshime të treguesve brenda njësive.

Për kërkesat për ndryshim të kufijve të njësive strukturore dhe të treguesve zhvillimor, ndryshimi i kufirit lidhet kryesisht me reflektimin e gjendjes ekzistuese, pra cënimi në mjedis përsëri nuk ndryshon, por vetëm pasqyrohet në PPV.

Bazuar në këto që thamë, si dhe bazuar në legjislacionin në fuqi:

- Ligjin Nr. 91/2013 "Për Vlerësimin Strategjik Mjedisor",
- Ligji Nr. 107/2017 "Për planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar
- Ligjin Nr. 57/2020 "Për pyjet",
- Ligjin Nr. 9587, datë 20.07.2006 "Për mbrojtjen e biodiversitetit", i ndryshuar,
- Ligjin Nr. 10 006, datë 23.10.2008 "Për mbrojtjen e faunës së egër" të ndryshuar,
- Ligjin Nr. 10 431, datë 09.06.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit", i ndryshuar,
- VKM Nr. 418, datë 27.5.2020 "Për Miratimin e dokumentit të politikave strategjike dhe të Planit Kombëtar për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve, 2020–2035",
- VKM Nr. 686/2017 "Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit", i ndryshuar

eksperti mjedisor i bashkisë Kavajë vlerëson se ndryshimet në rishikimin e Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Kavajë:

- *Nuk çënojnë vlerat natyrore dhe mjedisore*
- *Nuk kanë nevojën që ti nënshtrohen procesit të Vlerësimit Strategjik Mjedisor pasi janë të përfshira në VSM që ka hartuar PPV në fuqi.*

**Punoi : Albi SHTINI**

